

Dhjetor, 2016

Biografia dhe Programi Olimpik 2016 - 2020

“UNITETI PROFESIONAL”



Z. Jeton Beqiri

Kandidat për President të Komitetit Olimpik të Kosovës
Nominuar nga Federata e Ping Pongut e Kosovës

BIOGRAFIA SPORTIVE DHE PROFESIONALE

BIOGRAFIA SPORTIVE

- Sportist aktiv i ping pongut mbi 25 vite (nga viti 1990)
- Kampion Individual i Kosovës për Seniorë – viti 2000
- Kampion Ekipor i Kosovës – viti 2002
- Gjyqtar Ndërkombëtar i Ping Pongut (titulli: White Badge) – viti 2004
- Sportist i Përfaqësueses së Kosovës në Turneun Ndërkombëtar në Sofie, Bullgari – viti 2000
- Sportist i Përfaqësueses së Kosovës në Kampionatin Botëror në Guangzhou, Kinë – viti 2008
- Trajner i Licencuar i ping pongut nga ITTF (Federata Ndërkombëtare e Ping Pongut) – viti 2008
- Gjyqtar Ndërkombëtar i Ping Pongut (titulli më i lartë i mundshëm: Blue Badge) – viti 2009
- Anëtarë i Bordit të Federatës së Ping Pongut të Kosovës që nga viti 2007, udhëheqës i zyrës për Marrëdhënie Ndërkombëtare, udhëheqës i bisedimeve të ndërlikuara në vitin 2007 me Serbinë, në vitin 2008 me Kinën dhe në vitin 2010 me Rusinë të ndërlidhura asokohe me moslejimin e pjesëmarrjes së përfaqësuesve tona në Kampionatin Evropian, respektivisht ato Botërore
- Hartues dhe fitues i projektit/donacionit "ITTF Goodwill Fund" (tri shtete përfituese nga e tërë bota)
- Gjyqtar Ndërkombëtar në shtatë Kampionate Botërore dhe në tetë Kampionate Evropiane
- Gjyqtar Ndërkombëtar në Kupën e Botës
- Nënkryetar aktual i Federatës së Ping Pongut të Kosovës dhe kryetar i klubit të ping pongut "Ahmet Hoxha"
- Anëtar i Komitetit të Gjyqtarëve dhe Arbitrave Suprem të Unionit Evropian të Ping Pongut (ETTU) për periudhën 2014 – 2018
- Arbitër Suprem i Kualifikimeve për Kampionatin Evropian 2017 (nominuar nga ETTU)
- Gjyqtar Ndërkombëtar (ITO) në Lojërat e para Evropiane në Baku 2015 (me normë olimpike)
- Gjyqtar Ndërkombëtar (ITO) në Lojërat Olimpikë Rio 2016 (me normë olimpikë)

BIOGRAFIA PROFESIONALE

- Bachelor për Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, Master në vijim për Shkenca Kompjuterike
- Drejtor për TI për Evropë, Lindjen e Mesme dhe Afrikë
(në kuadër të kompanisë kanadeze FreeBalance Inc me seli qendrore në Ottawa që nga viti 2003)
- Ekspert për TI në Ministrinë e Financave / Thesari i Shtetit të Kosovës për SIMFK
(Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës)
- Ekspert për TI në Autoritetin Kombëtarë të Kualifikimeve në Kosovë

INFORMATA PLOTËSUESE DHE DETAJE TË KONTAKTIT

- I lindur më 19 tetor 1975 në Prishtinë
- Banon në Prishtinë që nga viti 1993, është i martuar dhe ka dy fëmijë
- Komunikon rrjedhshëm edhe në gjuhën angleze, gjermane dhe serbokroate
- Nuk ka qenë asnjëherë anëtar i ndonjë partie politike dhe nuk ka pasë asnjëherë vepër gjyqësore/penale
- Email adresa: jeton@fppk.com
- Numri i celularit: +386-49-113-979

PROGRAMI OLIMPIK 2016 – 2020

"UNITETI PROFESIONAL"

Të nderuar Delegatë të Asamblesë së VII Zgjedhore të Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK),

me kënaqësi dhe i privilegjuar ju drejtohem sot për të ju njoftuar me informacionin se Federata e Ping Pongut të Kosovës ka vendosur të përkrahë nominimin tim zyrtar për pozitën e presidentit të KOK-ut dhe me këtë rast kam nderin të ju njoftoj në vijim me programin tim të përgjithshëm për ciklin olimpik 2016 – 2020 me moton "Uniteti Profesional" në kuadër të KOK-ut në rast të përzgjedhjes së kandidaturës time për postin e presidentit të KOK-ut.

Programi im olimpik për katër vitet e ardhshme është i bazuar në gjashtë shtylla në vijim:

1. Rishikimi i Planit Strategjik 2016-2021
2. Ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe menaxhimi profesional
3. Ndryshimi i Legjislacionit, Sponsorizimi dhe Financimi
4. Komunikimi dhe Transparenca
5. Themelimi i Akademisë Olimpike të Kosovës
6. Promovimi i Lëvizjes Olimpike (dhe anti-dopingut) dhe Kartës Olimpike

1. Rishikimi i Planit Strategjik 2016-2021

- Do bëhet fillimisht një studim fizibiliteti për identifikimin e të gjitha proceseve, arritjeve dhe mangësive në KOK nga një grup i identifikuar i ekspertëve vendorë.
- Në bazë të studimit të fizibilitetit do të vlerësohet e rishikohet Plani Strategjik i KOK-ut dhe i njejtë do të diskutohet e debatohet me partnerët ndërkombëtarë e lokal siq janë autoritetet qeveritare sportive, federatat, shoqatat, sportistët, mediat e institucionet relevante sportive.
- Plani strategjik do të përmbajë në thelb objektivat, aktivitetet, resurset njerëzore dhe afatet kohore të caktuara me përpikmëri, me fokus të veçantë edhe mbi synimet për LO Tokyo 2020.
- Plani strategjik do të përfshijë edhe modifikimin e statutit të KOK-ut konform Kartës Olimpike pasi gjatë krahasimit të tyre është vërtetuar një diskrepancë e theksuar në promovimin e plotë të Lëvizjes Olimpike.
- Plani strategjik do të bazohet në parimin E³ (Eficient, Efektiv, Etik) dhe do përkojë me praktikat më të mira të njohura botërore.

2. Ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe menaxhimi profesional

- Do të punohet në ngritjen e mëtejme të kapaciteteve njerëzore e profesionale në KOK gjatë fazës së parë dhe mëpastaj me federatat sportive dhe udhëheqësit e klubeve sportive në vijim.
- Do të organizohen punëtori profesionale për administratorë sportivë në bashkëpunim me IOC, EOC, partnerët ndërkombëtarë e lokal.

- Do të intensifikohet bashkëpunimi me Komitetet Olimpikë të shteteve fqinje dhe rajonale me qëllim shkëmbimi të përvojave dhe programeve të dëshmuara të Lëvizjes Olimpikë.
- Duke marrë parasysh se njeriu është faktor kyç dhe bartës i të gjitha zhvillimeve, do të angazhohen ekspertët dhe profesionistët më të spikatur, do të ofrohen trajnime shtesë për ngritjen dhe avancimin e mëtejshëm të tyre, por edhe në krijimin e kapaciteteve të reja varësisht nga nevojat që dalin si rezultat i zhvillimit të vazhdueshëm.
- Në KOK do të definohet me saktësi decentralizimi i përgjegjësive, funksioneve e roleve në dy nivele, atë qeverisëse dhe menaxhuese.
- Menaxhimi qeverisës do bazohet në parimin dhe principet e përgjegjësisë dhe llogaridhënies, demokracisë, transparencës dhe solidaritetit.
- Monitorimi i performancës dhe vlerësimi sistematik i përmbushjes së misionit dhe detyrave konform programit zhvillimor.

3. Ndryshimi i Legjislacionit, Sponsorizimi dhe Financimi

- Aktiviteti i veçantë gjatë mandatit katër vjeçar padyshim do të jetë bashkëpunimi dhe partneriteti profesional dhe shtetërorë me autoritetet qeveritare në Kosovë. Do punohet në drejtim të ndryshimit e avancimit të legjislacionit për të ndërtuar një sistem të mirëfilltë të bursave dhe pagës për sportistët meritor, shpresat sportive e olimpikë, trajnerët e suksesshëm e punëtorët administrativë në federata dhe KOK. Ndryshimet e propozuara përmes legjislacionit do të përfshijnë edhe mbrojtjen juridike e materiale shtetërore të atletëve tanë elitë pas përfundimit të karrierës.
- Duke e parë të arsyeshme dhe të rëndësishme mënyrën e sponsorimit dhe financimit për promovimin e sportit kosovar në shkallë profesionale dhe nevojës për një infrastrukturë kompakte do të punohet me autoritetet qeveritare edhe në drejtim të gjetje së formave dhe arritjes së partneriteteve publiko private me theks të veçantë në përmbushjen e kushteve minimale infrastrukturore për zhvillimin e sporteve olimpikë.
- Do të vlerësojmë format më të mira për të veqar sportet dhe sportistët me interes kombëtarë dhe grupimin e niveleve dhe kategorizimin e tyre në përputhje me interesat shtetërorë.
- Do identifikohen shpresat olimpikë dhe do të implementojmë programin e solidaritetit Olimpik.
- Do të krijohen komisione të reja në KOK që do të merren ekskluzivisht me nxitjen e rritjes së të hyrave përmes programeve të marketingut dhe të drejtave të përdorimit të simboleve dhe të drejtave televizive me qëllim të investimit në programe profesionale në shërbim të sportistëve, trajnerëve dhe punëtorëve sportiv.
- Do të hartojmë projekte për mundësi të financimit të përhershëm të KOK-ut dhe të njëjtat do të tentojmë ti realizojmë me autoritetet qeverisëse apo private dhe mundësitë e tilla do të rekomandohen të bëhen në forma që nuk do e ngarkojnë shtresën e mesme dhe atë të ultë të qytetarëve dhe fokusi do të jetë në mundësitë si në vijim: shtimi i një takse të ultë prej 0.1% në pagat mujore të punëtorëve në Kosovë, shtimi i një takse të caktuar në produktet e alkoholit, duhanit dhe derivateve, shtimi i një takse fikse në telefoninë mobile në Kosovë. Mjetet e mbledhura do të përdoren në bashkëpunim të plotë me autoritetet qendrore dhe lokale me theks në ndërtimin e infrastrukturës sportive në Kosovë me qëllim të ofrimit të kushteve për sportistët tanë konform standardeve të pranuar ndërkombëtare.

4. Komunikimi dhe Transparenca

- Do bëhet ridizajnimi i ueb faqës zyrtare të KOK-ut.
- Do krijohen nënfaqe ueb-i për të gjitha federatat sportive që nuk posedojnë ueb faqe.
- Do krijohet një bazë e të dhënave përë komunitetin sportiv, përfshirë, sportistët, trajnerët, gjyqtarët, zyrtaret sportiv, etj.
- Do të krijohen faqe zyrtare të KOK-ut në rrjetet sociale të popullarizuara.
- Do të krijohet një aplikacion telefonik kompatibil per Android dhe iOS për KOK-un.
- Do të hapet një video faqe në Youtube për të promovuar aktivitetet e KOK-ut dhe Lëvizjes Olimpike në Kosovë.
- Do të publikohen në ueb faqe dhe në aplikacionin mobil për telefon të gjitha procedurat, dokumentet dhe vendimet e dalura nga KOK-u.
- Do publikohen online në baza tre mujore, gjashtë mujore dhe vjetore raportet financiare analitike dhe të përgjithshme dhe ato te audimit përfshirë kartelën e llogarisë bankare të KOK-ut.
- Do hartohet procedura për qasje në dokumente zyrtare dhe zbatimin e afateve kohore për pranimin e tyre duke respektuar ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, ligjin për qasje në dokumente publike dhe të gjitha ligjet tjera që ndërlidhen me transparencën publike.
- Do inicojmë krijimin e një komisioni të pavarur të mediave publike të Kosovës në kuadër të KOK-ut.
- Do hartohen procedurat për menaxhimin e riskut dhe monitorimin e konfliktit të interesit.

5. Themelimi i Akademisë Olimpike të Kosovës (AOK)

- Do të themelojmë një këshill profesional duke identifikuar dhe inkuadruar personat më meritore sportivë dhe intelektual, përfshirë profesionistët sportivë që jetojnë në Kosovë dhe ata në diasporë për të inicuar, hartuar dhe implementuar themelimin e Akademisë Olimpike të Kosovës (AOK).
- AOK do të sigurojë dhe monitorojë aktivitetin e anëtarëve të KOK-ut në promovimin e parimeve të Olimpizmit.
- AOK do të organizojë dhe asistojë institucionet sportive në organizimin e konferencave, seminareve, debateve apo ligjeratava në kuadër të kornizës së programit të KOK-ut me theks në promovimin e Lëvizjes Olimpike.
- Përgatitjen e tërësishme edukative, sociale e psikologjike të sportistëve, trajnerëve dhe zyrtarëve për pjesëmarrje në lojërat olimpike.
- AOK do bëjë dizajnimin, botimin dhe shtypjen e materialeve për promovimin e Olimpizmit.
- AOK do të angazhohet në zhvillimin e programe atraktive e kreative për inkuadrimitin e fëmijëve në sport, pavarësisht moshës, nivelit apo aftësive përmes programeve të ndryshme edukative shkollore, duke përfshirë edhe programe specifike për edukimin e mësuesve.

6. Promovimi i Lëvizjes Olimpike (dhe anti-dopingut) dhe Kartës Olimpike

- Formimi i komisionit të veçantë për monitorimin e aktiviteteve dhe modifikimin e akteve sportive e normative në Kosovë konform Lëvizjes Olimpike dhe Kartës Olimpike.
- Programi online i inkuadrimit dhe angazhimi të vullnetarëve në promovimin e Lëvizjes Olimpike.
- Organizimi i manifestimeve për të shënuar ditën Olimpike, promovimin e Lëvizjes Olimpike dhe çfarëdo aktiviteti që ndërlidhet me promovimin e Olimpizmit.

- Krijimi i Muzeut të KOK-ut i cili do të ketë në vehte edhe pjesën e librarisë së KOK-ut me të gjitha materialet në disponim që nga themelimi i KOK-ut, të pasuruar edhe me material të siguruar në bashkëpunim të ngushtë me IOC, EOC, autoritetet qeveritare të Kosovës dhe të gjithë pjesëmarrësit zyrtar që ndonjëherë kanë marrë pjesë në Lojëra Olimpikë.
- Ngritje e cilësisë së mjekësisë sportive me qëllim të kujdesit të shëndetit dhe sigurisë së sportistëve dhe punëtorëve sportive. Do të formohet ekipi i ekspertëve për diagnostikimin dhe zbulimin e talentëve të rinj për sportet përkatëse (qendra për Matje dhe Testime të talentëve por edhe të sportistëve, përkatësisht shpresave Olimpikë dhe atyre që garojnë për të plotësuar Normën Olimpikë).
- Dizajnimi dhe krijimi i maskotës dhe simboleve unike të KOK-ut me të drejta autoriale të rezervuara.
- Prioriteti ynë do bazohet padyshim në kontinuitetin e shtytjes dhe programeve të edukimit të të rinjëve për tu marrë me sport, programit të Sportit për të Gjithë, programit të Sportit të Femrave, kualifikimit të trajnerëve, shërbimet e mjekësisë sportive, edukimit mbi anti-dopingun, sporteve elitare, planifikimit pas përfundimit të karrierës dhe mbështetje përkatëse për atletët tanë.
- Ngritje e mëtejme e bashkëpunimit të ngushtë, të sinqertë dhe profesional me IOC dhe EOC.

Deklaratë për Kandidaturën e Pozitës së Presidentit të KOK-ut

Ju ftoj që të konsideroni përkrahjen tuaj për përzgjedhjen time në postin e Presidentit të KOK-ut.

Ju ftoj që të lexoni biografinë time për tu njoftuar për së afërmi me disa tipare dhe veçori që e karakterizojnë eksperiencën time profesionale mbi 25 vjeçare në fushën e sportit e cila përkon dhe është në përputhje me Olimpizmin, Lëvizjen Olimpikë dhe Kartën Olimpikë. Gjithashtu mund të gjeni edhe disa informacione rreth karrierës sime profesionale të cilat më japin konfidencë se unë mund ti arrijë objektivat të cilat i përcaktojë mëparë. Bazuar në programin dhe biografinë time do të kuptoni se unë nuk kam vetëm ide por jam edhe person me kompetencë edhe për arritjen e rezultateve të matshme dhe se në jetën time kam tejkaluar edhe shumë situata e sfida të ndërlikuara dhe ju premtoj sinqerisht në angazhimin tim maksimal që në formë ekipore e profesionale siç edhe kam emërtuar këtë program të përgjithshëm me moton "Uniteti Profesional", të punojmë e veprojmë së bashku nën frymën e Lëvizjes Olimpikë për të mirën e Olimpizmit konform Kartës Olimpikë.

Së fundmi, më lejoni të falenderoj Kryetarin dhe Bordin Ekzekutiv të Federatës së Ping Pongut të Kosovës për përkrahjen dhe besimin e dhënë me rastin e nominimit tim, familjen dhe të gjithë miqtë e komunitetit sportiv e profesional si dhe bashkëpunëtorët ndërkombëtarë sportiv nga Federata Ndërkombëtare e Ping Pongut (ITTF) për shtytje dhe përkrahje të parrezervë për këtë kandidaturë të rëndësishme për mundësinë e promovimit të mëtutjeshëm të Lëvizjes Olimpikë dhe sportit të Kosovës në përgjithësi.

Ju faleminderit për konsiderimin tuaj.

Sinqerisht,

Jeton Beqiri

049-113-979

jeton@fppk.com